

# Rrugët e arsimit shkollor

## Angazhim më shumë, më shumë detyra shtëpie

Nxënësit/nxënëset e gjimnazit apo të shkollave të mesme shkojnë me dëshirë në shkollë, mësojnë me dëshirë dhe kanë mundësi dhe duan-në krahasim me shkollimin e detyrueshëm fillor- të angazhohen më shumë për shkollën si dhe të mësojnë më shumë. Nuk i pengon se duhet të bëjnë nga dy, ndoshta edhe tri orë në ditë detyra të shtëpisë. Që pranimi në një gjimnaz ose shkollë të mesme speciale të bëhet realitet, ata qysh gjatë shkollimit të obligueshëm janë nxënës të mira dhe nxënës të mirë. Ata ndjekin nivelin sekondar I me kërkesa të zgjeruara, kanë nota të mira – minimum 4.5-në të gjitha degët dhe tregojnë interesim të gjerë.

## Çka flet në favor të një arsimit të mëtejshëm në një shkollë:

- Ju pëlqen shkolla dhe dëshironi të mësoni edhe më shumë.
- Ju pëlqen kontakti i përditshëm me bashkëmohatarët.
- Ju jeni i/e interesuar për shumë tema të ndryshme gjegjësisht lëndë mësimore, dhe ju pëlqen t'i shkoni gjërave deri në fund.
- Jeni i/e gatshëm/me të punoni edhe më shumë në vitet e ardhshme, sesa në shkollimin e detyrueshëm.
- Ju keni synime të qarta profesionale, për të cilën gjë shkollimi i mesëm përbën bazë të mirë.
- Ju jeni tashmë i/e mirë në shkollë dhe ndiqni nivelin sekondar me kërkesa të zgjeruara gjegjësisht të nivelit të lartë dhe keni një mesatare të mirë të notave.
- Mësueset/mësuesit tuaj ju konsiderojnë si të aftë për të mbaruar me sukses një gjimnaz ose shkollë të mesme.

## Bisedat dhe testet e këshillimores profesionale si mbështetje

Këshillimorja profesionale ju mbështet gjatë këtyre vendimeve, ajo ju ndihmon gjatë kërkimit të një shkolle të mëtejme ose të një zgjidhjeje të ndërmjetme. Lajmërohuni te Qendra Rajonale për Këshillime në rajonin tuaj ose në shkollë për një bisedë personale. Këtu mund t'i sqaroni më saktësisht interesat dhe aftësitë tuaja, sipas dëshirës edhe me anë të testeve. Me këshilltarin ose këshilltaren tuaj profesionale mund të diskutoni mbi vendimet, të mendoni mbi alternativat, merrni këshilla për aplikim dhe planifikoni hapat e ardhshëm.

## Gjetja e një shkolle të përshtatshme

Në të gjitha kantonet ekzistojnë oferta të ndryshme për edukim shkollor. Në tubimet informative ose në ditët e dyerve të hapura mund të gjeni nëse mësimi, atmosfera dhe bashkënxënësit i përgjigjen asaj çfarë ju paramendon.

Në faqen e internetit të Drejtorisë për Edukim gjegjësisht Arsimit të kantonit tuaj (shih në [www.edk.ch/dyn/13446.php](http://www.edk.ch/dyn/13446.php)) shkollat e tjera të mesme mund të gjenden shpesh nën shprehjen përmbledhëse „Shkollat e mesme“.

Pas nivelit sekondar I mund të mbaroni këto lloje të arsimit:

## Gjimnazi

Në gjimnaz përcillni një numër të caktuar të lëndëve të obligueshme themelore. Përveç këtyre keni edhe një lëndë shtesë dhe një lëndë kryesore. Në lëndën kryesore vendosni në një mënyre edhe për një profil të caktuar. Domethënë ju i jepni vetes një drejtim, në të cilin i shihni interesat tuaja kryesore të ardhshme profesionale si gjatë shkollimit në gjimnaz ashtu dhe më vonë në studime.

Në Zvicrën gjermane ju mund të zgjidhni nga një seri të profileve të ofruara më të përshtatshmin për ju. Gjatë zgjedhjes së gjimnazit, vini re cilat profile të maturës ofrohen: ju duhet të vendosni për një profil të caktuar të maturës.

Informohuni mbi modelet e maturës në kantonin tuaj në faqen e internetit të Drejtorisë për Edukim gjegjësisht për Arsimit dhe merrni pjesë në tubimet organizuara informative.

### Shkollat e mesme speciale (FMS)

Shkollat e mesme speciale janë bazë e fortë për shkollime profesionale më të sofistikuar në degët profesionale,

- Shëndetësi / shkencat e natyrës
- Komunikim / medie
- Pedagogji
- Ponë sociale
- Dizajn/art
- Muzikë/teatër/vallëzim

Informohuni mbi veçantitë e kantonit tuaj në faqen e internetit të Drejtorisë për Edukim gjegjësisht për Arsimit dhe merrni pjesë në tubimet gjegjëse informative.

### Shkollat e plota me arsimim profesional (Certifikata Federale e Aftësisë)

Sidomos në Zvicrën italiane dhe frankofone, profesionet mund të mësohen edhe në shkollat me orar të plotë. Në Zvicrën gjermane kjo kufizohet kryesisht për arsimimin në degë të tregtisë komerciale dhe për shkollat e informatikës.

### Pranimi në shkollat e tjera (të mesme)

Kalimi në shkollat e tjera (të mesme) dallon prej kantonit në kanton. Pra janë të rregulluara ndryshe. Informacionet e sakta mbi procedurat e pranimit i gjeni në faqen e internetit të Drejtorisë për Edukim gjegjësisht për Arsimit të kantonit tuaj ose në faqet e internetit të shkollave të ndryshme. Edhe mësimdhënësi i klasës dhe Këshillimorja për Profesionet mund të ju informojnë saktësisht mbi këto procedura.

### Përgatitja personale

Shumica e nxënësve/nxënësve të cilët ose të cilat synojnë hyrjen në një shkollë të mesme, përgatiten në klasën e dytë të nivelit sekondar I për këtë kalim. Bazë janë notat e mira në dëftesë, veçanërisht në lëndët kryesore mësimore.

Atje ku ka provimet pranuese, shumica e mësimdhënësve të klasës u japin nxënësve dhe nxënësve të tyre provimet e vjetra pranuese, për t'i shikuar dhe për t'i përpunuar. Provime të tilla gjeni në faqet e internetit të shkollave të mesme në kantonin tuaj ose të Drejtorisë së Edukimit/Drejtorisë për Arsimit.

Në shumë komuna, shkollat sekondar organizojnë kurse përgatitore për provime të tilla pranuese, falas dhe jashtë orarit të mësimit të rregullt. Mësimdhënësi i klasës është i informuar për to.

Së fundi, kurse përgatitore për provime pranuese ofrojnë edhe shumë institute komerciale.

### Koha e provës

Pas pranimit në gjimnaz, në shumë kantone, nxënësit dhe nxënëset duhet të mbarojnë një periudhë provuese (2 deri në 3 muaj ose një gjysmë-vjetor), dhe ndonjëherë edhe në fund të vitit të kalojnë provimet promovuese, për të të hyrë në provime të maturës pas 3-4 vjetësh.